

RELACION TEKNIK

Shkolla "Jorgji DILO" ndodhet ne Lagjen "28 NENTORI" ne veri te rruges Qemal STAFJA" dhe ne jug te Ndermarrjes elektrike.

Hyrja kryesore e shkolles eshte ne anen jugore nga rruga "Qemal STAFJA".

PERSHKRIMI I GJENDJES EGZISTUESE

Shkolla eshte 3 kate dhe eshte ndertuar me konstruksion tulle me soleta. Objekti ka nje siperfaqe funksionale te bollshme dhe ne te jane organizuar aktualisht ambiente rekreacioni dhe nje fushe volejbolli por ne gjendje te degraduar dhe si pasoje e materialeve qe jane perdorur, gjithashtu dhe gjelberimi I shkolles eshte I degraduar dhe me peme te mbjellura ne menyre kaotike dhe ndricimi I jashtem I shkolles mungon. Objekti eshte ne forme drejtkendore dhe ka nje siperfaqe egzistuese si me poshet:

- Siperfaqe territorit funksional sip = 3487m²
- Siperfaqe te objektit ne katin perdhe 621.3m² nga e cila sip= 90.7 m² eshte verande
- Siperfaqe te katit pare (teknik) sip = 530.6 m²
- Siperfaqe te katit dyte (teknik) sip = 530.6 m²

Pas rikonstruksionit shkolla do te kete keto siperfaqe si me poshte:

- Siperfaqe te objektit ne katin perdhe sip = 1582.3 m²
- Siperfaqe te katit pare (teknik) sip = 1638.7 m²
- Siperfaqe te katit dyte (teknik) sip = 1060.8 m²

Shkolla ne total ka 30 ambiente kalasa + laborete + zyra dhe ka nyje sanitare per cdo kat te cilat jane ne gjendje jo te mire konform standarteve te kerkuara dhe gjithashtu klasat jane ne siperfaqe te reduktuar ne raport me **UDHEZIMIN PER PROJEKTIMIN E NDERTESAVE SHKOLLORE NORMAT DHE STANDARTET.**

Shkolla eshte e amortizuar nga ana e materialeve ndertimore ku problematike paraqiten dritaret te cilat nuk permbushin kushtet e termoizolimit pasi jane tek xham, suvatimet e objektit jane ne gjendje te degraduar dhe ne vende te caktuara eshte I shkeputur nga muret, kati I dyte teknik ka tavan te varur me kallama te suvatuar ne gjendje mjaft te keqe ku ne siperfaqe te caktuara ka cedime c'ka perben rrezik per nxenesit, pllakat jana granili shume te vjetra te cilat ne vende te caktuara jane te thyera.



Evidentimi I problematikave ne menyre te koncentruar per Shkollen.

- Hidroizolimi i taraces eshte i demtuar dhe duhet bere i ri se bashku me shtresen termoizoluese.
- Suvatimet ne pergjithesi te tavanaeve jane te krisura kurse te mureve jane dhe te demtuara.
- Shtresat e dyshemeve jane me pllaka cimento te konsumuara. Shkallet jane te veshura me granil te cilat jane bere shume te rreshqitshme.
- Dritare jane prej druri te demtuara te levizura nga vendet dhe jane me davancale granili te demtuara. Dritaret e anes jugore e lindore jane duralumin.
- Dyert jane prej druri te demtuara dhe pa xhama.
- Suvatimet e jashtme jane ne gjendje te mire pervec 1m ne pjesen e poshtme qe eshte demtuar dhe duhet te priset e te behet e re.
- Kompleksi i banjove brenda shkollës eshte ne gjendje te mjeruara me WC allaturke te demtuara dhe pa kasetat e shkarkimit. Lavamane jane te demtuar. Dyert e banjove jane druri dhe te demtuara dhe duhet te nderrohen. Te gjitha banjot rrjedhin dhe si rrjedhim duhet hidroizolim i ri I banjove dhe instalime te reja tubacionesh.
- Instalimet elektrike nuk i pershtaten kohes dhe do te ribehen. Panelet dhe kudrot e komandimit jane komplet te demtuara.
- Rrjeti i IT ka ardhur me linje ajrore dhe eshte vendosur ne objekt me kanalina.
- Furnizimi me uje behet nga rrjeti dhe eshte ne pune vetem kur linja ka uje.
- Shkolla nuk ka sistem ngrohje

AMBIENTI I JASHEM

- Shkolla eshte e rrethuar ne tre ane (lindje, jug e perendim me mure me blloqe 20 cm dhe kangjella metalike i cili eshte ne gjendje jo te mire por do te nderhyhet duke bere mure te ri B/arme dhe me kangjella.
- Hyrja per ne shkolle eshte me shtrese betoni te demtuar dhe do te zevendesohet me hyrje te shtruar me pllaka betoni.
- Do te sistemohen ambientet jashte me lulishte stola dhe vendet e qendrimit te nxenesve gjate pushimit.

RESTAURIMI i SHKOLLES " JORGJI DILO"

Duke u nisur nga tere problematikat qe renditem me siper te cilat jane patur parasysh ne realizimin e projektit te restaurimit por edhe nga udhezimi per shkollat te cilat duhet te ushtrojne aktivitetin e tyre mesimor me nje turn (paradite) eshte pare arsyeshme te realizohet nje shtese anesore ne anen veri-lindore te objektit egzistues per shtese ambientesh 3-kat dhe 2-kat. Shtesa e re mundeson krijimin e ambienteve si me poshte:

11- Ambienteve mesimore

- 1- Palestre sportive me anekset ndihmese
- 2- Nyje sanitare per palestren per djem dhe vajza
- 3- Ambiente per zyra per mesuesit
- 1- Salle te madhe biblioteke ose organizimesh

Duhet te permendet qe te tera ambiente jane konform standarteve te projektimit per ndertesat shkollore.

Veranda e cila eshte ne katin perdhe me strukture betoni do te pushtet dhe do te realizohet me strukture metalike e veshur me gips cimentato per te krijuar nje strukture dekorative per trajtimin arkitektonik te objektit.

Dritaret do te zhvendosen duke krijuar sfazime ne fasade ndermjet dritareve nga kati ne kat, dritaret e reja do te jene dopioxhamdhe me hapje vertikale.

Suvatimet e jashteme do te behen me grafiato Nr.1 dhe lyerje me boje plastike rezistente per ambientet e jashtme. Ne anen perendimore do te ndertohen dhe shkallet e emergjences ne rast emergjencash dhe ndertimi I ambienteve per kaldajen dhe magazinimin e peletit.

Nisur nga rifiniturat e brendshme do te vendosen dyer per cdo klase me hapje nga jashte dhe zjarrdruese, pllakat e poshteme do te jene ratifikate gres porcelanate me shtrim pa fugature.

Murete brendshme do te suvatohen dhe do te lyhen me boje hidromat ekologjike, palestra do te shtrohet me parket druri conform standarteve.

Ambienti I jashtem do te sistemohet duke krijuar ambiente rekreative bashkohore per nxenesit nga ate cilat mund te permendim restaurimin e sheshit ne anen jug –lindore duke krijuar nje shesh te bollshem dhe per aktivitete te ndryshme por dhe nje vendqendrimi ne forme anfiteatri per nxenesit I cili do te realizohet me strukture betoni dhe bazamentet ulese me derrase, pjesen tjeter te lulishtes krijohet hapesire e gjelber me nje rrugice qendrore per piste vrapimi por sherben edhe si pasarele kalimi per nxenesit gjate pushimit qe mund te kene. Gjelberimi do te jete totalisht I ri me perjashtim te nje peme palme e cila eshte mjaft e xhvilluar dhe dekorative ndersa pemet qe do te perdoren ne perimeter pergjate rrethimit do te jene peme dekorative (MANJOLE) me kurore te trajtueshme. Hapesirat e gjelberta do te mbilen me bar dekorativ tek tecilet do te kete dhe ishuj me lule dekorative (nano)

PUNIMET QE DO TE KRYHEN**SHKOLLA**

- Do te behet termoizolimi i soletes se katit te dyte teknik me 10 cm polosterol dhe mbi te do te behet shtresa niveluese me beton C16/20 per te dhene pjerresine me trashesi mesatare 8 cm.
- Do te behet hidroizolimi taraces me dy karton katrama.
- Do te vendosen te reja impluvet e llamarines si dhe ulluket vertikale e horizontale.
- Do te prishen te gjitha suvatimet brenda dhe do te ribehen te reja.
- Do te prishen te gjitha shtresat e pllakave dhe do te behet shtrimi i tyre me pllaka gres porcelanate.
- Shkallet pas prishjes se veshjes me granil do te behen me veshje mermeri.
- Suvatimi i jashtem do te behet me sistem kapote dhe me grafiato. Shkolla eshte e larte nga toka 45 cm dhe xokoli do te vishet me traventin.
- Te gjitha davanalet e dritareve do te behen prej mermeri.
- Dritaret dhe dyert qe jane ne kontakt me ambientin e jashtem do te jene prej duralumini me dopio xham.
- Dyert qe jane ne katin perdhe ne kontakt me ambientin e jashtem do te jene dyer te blinduara.
- Dritaret e katit perdhe do te jene me kangjella hekuri.
- Lyerja e ambienteve brenda do te behet me boje hidroplastike. Koridoret ne lartesine 1.40 m do te lyehen me boje hidroplastike importi cilesia e pare njelloj si dhe lyerja e ambienteve te jashtme.
- Instalimet elektrike do te behen te reja.
- Ne te gjitha banjot egzistuese do te behen te gjitha punimet e reja qe nga instalimet deri tek suvate dhe veshjet me pllaka.
- Furnizimi me uje do te jete furnizimi egzistues.
- Eshte parashikuar qe linja IT te merret nga pika e lidhjes deri tek shkolla nen toke si dhe dergimi i saj deri ne ambientet e duhura.

AMBIENTET E JASHTME

- Muri rrethues do te ribehet me lartesine 1.2 m dhe mi te deri ne lartesine 2.5 m do te vendosen kangjella metalike. Muret e jashtem do te lyehen me boje hidroplastike.
- Do te ribehen te gjitha trotuaret me pllaka betoni te shkolles e palestres.
- Palesta do te shtrohet me parket.

- Sheshi para shkolles dhe ne hyrjen nga ana perendimore do te shtrohet me pllaka betoni
- Ujrat e shiut jane sistemuar ne kanale nentokesore me tubo betoni O 200 mm.
- Jane parashikuar dhe vendosje stolash si dhe kosha plehrash.
- Ne ambiente e lulishteve jane parashikuar mbjelljet me bare si dhe mbjellje pemesh dekorative.
- Do te vendosen shtylla te reja ndricimi dhe ndricues sodium 250W.

Per sa me siper bashkengjitur jane:

1. Projektet perkatese
2. Relacioni teknik
3. Pershkrimi punimeve
4. Preventivi i punimeve.

HARTOI

Ark. Marvis Avllazagaj

Ing.Konstruktor **Reshit BEDHIA**


Ing.Hidroteknik **Erion STAMBOLLXHIU**

Ing.Eleketrik **Kleodjan BIXI**

Drejtori Drejtorise Planifikimit te

Territorit dhe Projektimit

ark.Gentian TABAKU



KRYETARI BASHKISE

Qazim SEJDINI